



Implemented by

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

DANIDA




The Danish  
Neighbourhood  
Programme



# UDHËZUES PËR APLIKANTËT

Skema e Grantit "SARED" për Mbështetjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik Bujqësor të Zonave Rurale të Pafavorizuaranë Shqipëri



## TURIZMI RURAL

Dhjetor 2016

## Tabela e Përmbajtjes

1.	Skema e Grantit SARED.....	3
1.1	Hyrje .....	3
1.2	Përkufizimet Kryesore .....	4
1.3	Objektivat e Përgjithshme të Skemës së Grantit SARED .....	5
2-	Zinxhiri i Vleres, dhe përfituesit e pranueshëm .....	5
2.1-	Investimet e pranueshme dhe Zinxhirët e Vlerës .....	5
2.2	Kriteret e pranueshmërisë për Aplikantët në përputhje me ZV 4 (Turizmi Rural) .....	5
2.2.1	Kush mund të aplikojë? .....	5
2.2.2	Kriteret e pranueshmërisë për aplikantët në lidhje me statusin, pronësinë dhe mbulimin territorial .....	5
2.2.3	Kriteret e pranueshmërisë për aplikantët në lidhje me detyrimet financiare .....	6
2.2.4	Kriteret e pranueshmërisë në lidhje me investimet .....	7
2.3	Kushtet Financiare të Projekteve për Investime të Pranueshme .....	7
2.3.1	Minimumi dhe Maksimumi i investimevetë pranueshme .....	7
2.3.2	Intensiteti i ndihmes (Shuma maksimale e grantit) .....	7
3.	Rregullat për shpenzimet e pranueshme .....	8
3.1	Shpenzimet e Pranueshme në kuadrin e ZV 3 .....	8
3.2	Investime dhe Shpenzime të Papranueshme .....	9
4.	Objektivat specifikë të investimeve të pranueshme nëkuadrin e ZV 4 – Turizmi Rural .	10
5.	Procedura e Aplikimit.....	11
5.1	Thirrja për aplikime.....	11
5.2	Kritere për dorëzimin e Aplikimeve .....	11
5.3	Përmbajtja e dosjes se Aplikimit .....	11
5.4	Përzgjedhja dhe Renditja e Aplikimeve .....	14
6.	Shënime të rëndësishme në lidhje me pranueshmërinë/refuzimin e Aplikimeve .....	15
6.1	Refuzimi për gabime madhore .....	15
6.2	Kërkesa për ridorëzimin e dokumenteve për gabime të vogla .....	15
6.3	Raste të tjera.....	16
7.	Kontrollet në vend perpara firmosjes së kontratës .....	16
8.	Njoftimi i Aplikantëve në lidhje me marrjen e vendimit .....	16
9.	Kontrata për dhënien e grantit .....	17
11.	Kohëzgjatja e zbatimit të një projekti investimi .....	17
12.	Vizibiliteti i investimit dhe kontrollet pas financimit .....	17
13.	Si paguhet Granti? .....	17
14.	Dorëzimi i Kërkesës për Pagesë (KpP)–Miratimi / Kryerja e pagesës .....	18
14.1	Kritere për dorëzimin e KpP-ve .....	18
14.2	Dosja e KpP-së.....	18
15.	Kontrolli në Vend para pagesës .....	19
16.	Pagesa e Grantit (kryerja e pageses) .....	19
17.	Përmbledhje e disa Shënimeve të Rëndësishme për të gjithëAplikantët.....	20
18.	Shtojcat: .....	21

## 1. Skema e Grantit SARED

### 1.1 Hyrje

Programi gjermano-danez “Mbështetja për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural në zonat e prapambetura të Shqipërisë” – SARED është një program me financim të përbashkët nga qeveria e Danimarkës dhe ajo e Gjermanisë në përputhje me objektivin e Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural për Shqipërinë (ISARD 2014 - 2020).

Synimi i SARED është që të rrisë qendrueshmërinë dhe performance e ekonomisë rurale në zonat e e paavantazuara malore në atë mënyrë që të sjellë nje impakt me bazë të gjerë. Një nga komponentët e SARED është zbatimi i një Skeme Granti për investime për zhvillimin e turizmit rural. Skema e Grantit është e bashkëfinancuar nga vete përfituesit e grantit.

Skema e Grantit SARED per zhvillimin e turizmit rural do të zbatohet nga GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) në bashkëpunim me MBZHRAU dhe do të operojë në Shqipëri në territorin e 3 bashkive (Kukes, Peshkopi dhe Skrapar) që shtrihen përkatësisht në qarkun Kukës, Dibër dhe Berat.

Buxheti i përgjithshëm orientues për ZV 4 “Turizmi Rural” është 500,000 euro ose mesatarisht 150,000 euro për secilën nga tre Bashkitë. Në rastet kur buxheti nuk është përdorur në një nga bashkitë për shkak të mungesës së aplikimeve, ai mund të rishpërndahet tek bashkitë e tjera nëse nevojitet.

Ky Udhëzues për Aplikantët përcakton rregullat për dorëzimin, vlerësimin, kontraktimin, zbatimin e investimit, dorëzimin e Kërkesës për Pagesë, “kontrollet e rastësishme” dhe kryerjen e pagesës sipas Skemës së Grantit në **Zinxhirin e Vlerave 4 “Turizimi Rural”**.

Ky Udhëzues së bashku me të gjithë informacionin që lidhet me Thirrjen për Aplikim mund të shkarkohet nga faqja e internetit:

[www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al)

ose duke klikuar në adresën e mëposhtme:

<http://www.bujqesia.gov.al/al/programi/projekti-sared>

## 1.2 Përkufizimet Kryesore

- **UpA:** Udhëzuesi për Aplikantët
- **Autoriteti Kontraktues:** GIZ / SARED
- **Aplikant:** është një fermer individual, një person fizik apo juridik i regjistruar, i cili dorëzon një aplikim për marrjen e njëgranti në përputhje me Thirrjen për Dorëzimin e Aplikimeve;
- **Përfitues** (ose përfitues i grantit): është një person fizik apo juridik, të cilit i është dhënë një grant për zbatimin e investimit (projektit).
- **Projekt investimi:** përbëhet nga një sërë aktivitetesh investimi në aktive të luajtshme dhe të paluajtshme me synim përmbushjen e objektivave të sektorëve që mbështet skema e grantit.
- **Grant:** është një pagesë nga Autoriteti Kontraktual për rimbursimin e një pjese të shpenzimeve të pranueshme të bëra nga përfituesi për projektin e investimit në aktive të luajtshme dhe të paluajtshme.
- **Vendimi për dhënien e grantit dhe nënshkrimin e kontratës:** është vendimi që merr autoriteti kontraktues për dhënien e grantit aplikantit të suksesshëm mbi bazë të kontratës që nënshkruhet ndërmjet tyre.
- **Vendimi për autorizimin dhe kryerjen e pagesës së grantit:** është vendimi i autoritetit kontraktues që autorizon shumën e grantit dhe kryerjen e pagesës. Ky vendim merret pas vlerësimit pozitiv të kërkesës për pagesë që paraqet aplikanti.
- **Kontributi publik (SARED):** është shuma e kontributit financiar dhënë nga GIZ/SARED, e cila është e barabartë me 50% - 65% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të projektit të investimit.
- **Kontributi i përfituesit:** është shuma e kontributit financiar dhënë nga përfituesi, e cila është e barabartë me 35% - 50% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të projektit të investimit.
- **Shpenzime të pranueshme:** janë shpenzimet e miratuara në përputhje me kërkesat e Skemës së Grantit të renditura në Kreun përkatës të këtij Udhëzuesi për Aplikantët dhe parashikuar në kontratën e nënshkruar.
- **NjAQV:** Njësi Administrative të Qeverisjes Vendore
- **Aplikant i ri:** aplikant nën moshën 40 vjeç në ditën e aplikimit.
- **Bujtinë:** është një ambient në një zonë të përcaktuar rurale me kapacitet ndërmjet 6 dhe 25 shtretërisht për pritjen dhe sistemimin e klientëve.
- **Ambient për argëtimin e turistëve (bar kafe – restorant) në zonat rurale:** është një ambient për pritjen e 10 deri në 30 turistëve njëherazi (tavolina dhe karrige për deri në 30 klientë).
- **Rikonstruksion:** rinovimi/rimobilimi i një ndërtese/godine ekzistuese (pa përfshirë zgjerimin).
- **Ndërtim:** ndërtim i një ndërtese/godine të re ose zgjerrimi/përshtatja e një shtëpie ekzistuese ose godine bujqësore ose e një bujtine, një bar-kafe/restoranti dhe ambienteve të tjera të renditura në LEE në qarqet/zonat e përzgjedhura.

### 1.3 Objektivat e Përgjithshme të Skemës së Grantit SARED

Objektivat e përgjithshme të Skemës së Grantit për zhvillimin e sektorit të turizmit rural në zonat e pranueshme rurale janë si më poshtë:

- Të kontribuojë në rritjen e konkurrueshmërisë të zonave rurale shqiptare duke shtuar investimet dhe kapacitetet përthithëse të aktorëve ekonomikë në përputhje me ZV-të e pranueshme;
- Te kontribuojenë në gjelbërimin gradual të aktivitetit ekonomik të fermave/stabilimenteve bujqësore në zonat rurale nëpërmjet investimeve në energjinë e rinovueshme dhe ato që mirëmbajnë mjedisin.
- Të kontribuojë në rritjen respektivisht stabilizimin e të ardhurave të familjeve rurale;
- Të kontribuojë në krijimin e vendeve të reja të punës apo në ruajtjen e atyre ekzistuese;
- Të kontribuojë në përmirësimin gradual të fermave/stabilimenteve bujqësore shqiptare në zonat rurale drejt plotësimit të standardeve kombëtare në fushën respektive të sigurisë dhe të cilësive ushqimore, të respektimit të mbrojtjes së mjedisit dhe të traditës e kulturës tek bujtinat.

## 2- Zinxhiri i Vlerës, dhe përfituesit e pranueshëm

### 2.1- Investimet e pranueshme dhe Zinxhirët e Vlerës

**ZV 4 – Turizmi Rural**, në përputhje me të cilin janë të pranueshme

- Investimet në ferma që mbështesin kthimin e godinave bujqësore apo shtëpitë, etj, të fermës në godina akomoduese për turistët (mysafirët) ku ofrohet strehim, shërbehët ushqim dhe që krijojnë kushte argëtimi për familjet me fëmijë, etj.
- Investimet jashtë fermave që mbështesin bizneset e vogla, në krijimin e shërbimeve turistike duke përfshirë akomodimin, kafene dhe restorante dhe përmirësimin e standardeve të shërbimeve të tyre.

### 2.2 Kriteret e pranueshmërisë për Aplikantët në përputhje me ZV 4 (Turizmi Rural)

#### 2.2.1 Kush mund të aplikojë?

Skema e Grantit SARED është e hapur për fermerë individualë, persona fizikë dhe persona juridikë të cilët zotërojnë ose përfaqësojnë ndërmarrje shumë të vogla (mikro), të vogla, të mesme dhe që aktualisht ushtrojnë një aktivitet ose që dëshirojnë të fillojnë një aktivitet (start up) në turizmin rural në kuadrin e skemës së Granteve SARED duke plotësuar kriteret si më poshtë;

#### 2.2.2 Kriteret e pranueshmërisë për aplikantët në lidhje me statusin, pronësinë dhe mbulimin territorial

Në mënyrë që aplikantët të jenë të pranueshëm për grantin në përputhje me ZV 4, ata duhet të përmbushin të gjitha kriteret e renditura më poshtë:

- a) Ata duhet të jenë fermerë individualë të regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë përkatëse dhe të pajisur me kartë të fermerit ose NIPT fermeri, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre bujqësor në territorin e një nga të tre bashkitë e përzgjedhura paraprakisht, të cilët janë të gatshëm të investojnë dhe të përshtaten për turizmin rural,

- dhe që mund të provojnë pronësinë e tokës dhe/ose ndërtesës ku do të ushtrohet investues/aktiviteti, me dokumenta të lëshuar në përputhje me legjislacionin vendas (shiko kërkesat tek Formulari i Aplikimit – Shtojca 1 e UpA), **ose**
- b) Ata duhet të jenë persona fizikë të cilët kanë një aktivitet bujqësor ose tjetër aktivitet ekonomik në territorin e nje nga të tre bashkitë e përzgjedhura paraprakisht të cilët janë të gatshëm të investojnë dhe të përshtaten për turizmin rural, te cilet jane të rregjistruar sipas legjislacionit kombëtar dhe të licencuar nëse e kërkon legjislacioni vendas, dhe që mund të faktojnë pronësinë e tokës dhe/ose ndërtesës ku do të ushtrohet investimi/aktiviteti për te cilin aplikojne, me dokumenta të lëshuar në përputhje me legjislacionin vendas (shiko kërkesat tek Formulari i Aplikimit – Shtojca 1 e UpA) **ose**
- c) Ata duhet të jenë persona juridikë me pronësi 100% private të cilët kanë një aktivitet bujqësor ose tjetër aktivitet ekonomik në territorin e nje nga të tre bashkitë e përzgjedhura paraprakisht të cilët janë të gatshëm të investojnë dhe të përshtaten për turizmin rural, te cilet jane të rregjistruar sipas legjislacionit kombëtar dhe të licencuar nëse e kërkon legjislacioni vendas, dhe që mund të faktojnë pronësinë e tokës dhe/ose ndërtesës ku do të ushtrohet investimi/aktiviteti për te cilin aplikojne, me dokumenta të lëshuar në përputhje me legjislacionin vendas (shiko kërkesat tek Formulari i Aplikimit – Shtojca 1 e UpA) **ose**
- d) Të pranueshëm janë edhe fermerët individualë, personat fizikë, personat juridikë të cilët kanë marrë me qira tokën dhe/ose ndërtesën ose kanë një “kontratë për marrje në përdorim” për këto, për ti përdorur ato dhe për të investuar për një minimum prej 15 vitesh për investimet e pranueshme. Kontrata e qiramarrjes apo ajo e marrjes ne perdorim duhet të jetë e noterizuar e shoqëruar me dokumentat e pronësisë të lëshuara në përputhje me legjislacionin vendas (shiko kërkesat tek Formulari i Aplikimit – Shtojca 1 e UpA). Ai/ata duhet të paraqesin “kontratën e qirasë për marrje në përdorim” të noterizuar të shoqëruar me dokumentet e pronësisë të lëshuara në përputhje me legjislacionin vendas (shiko kërkesat tek Formulari i Aplikimit – Shtojca 1 e UpA). **Ose**
- e) Të pranueshëm janë fermerët individual të cilët jetojnë në shtëpitë e tyre (pronë e familjes) të ndërtuara para vitit 1990, por për të cilat ata nuk janë rregjistruar ende në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) dhe për rrjedhojë nuk mund të dorëzojnë dokumentin e pronësisë. Në këtë rast aplikanti duhet të dorëzojë një çertifikatë të lëshuar nga NjAQV-të (të firmosur dhe vulosur) që vërteton se shtëpia është ndërtuar para vitit 1990 dhe aplikanti jeton në atë shtëpi që nga ajo kohë.
- f) Të pranueshëm janë të gjithë aplikantët si më sipër të cilët jetojnë dhe kryejnë aktivitetin e tyre të pranueshëm ekonomik në territorin e NjAQV-ve të përzgjedhura në territorin e bashkive të mëposhtme; Bashkia e Kukësit (Qarku) Kukes, Bashkia e Peshkopisë Qarku Dibër dhe Bashkia e Skraparit Qarku Berat (shiko Shtojcën 4)
- g) Ata duhet të aplikojnë **vetëm për investime** në kuadrin e Zinxhirit të Vlerës turizmi rural dhe vetëm bazuar në listën e shpenzimeve/investimeve të pranueshme (Shtojca 3 e UpA).
- h) Aplikantët të cilët kanë dorëzuar një aplikim dhe janë në proces vlerësimi apo kanë nënshkruar nje ko trate per investime nen skemen e granteve SARED ne kuader te ZV 1-3 kane te drejte të aplikojne per investime ne turizmin rural pasi ata kane perfunduar investimin e kerkuar me aplikimin e pare dhe jane paguar per te nga GIZ.

### 2.2.3 Kriteret e pranueshmërisë për aplikantët në lidhje me detyrimet financiare

#### Aplikantët duhet:

- të kenë përmbushur të gjitha detyrimet financiare kundrejt shtetit, sic kërkohet nga ligji vendas në përputhje me statusin e tij/saj ligjor me te cilin aplikon duke përfshirë taksën mbi tokën në rastet kur ai/ajo është një fermer individual dhe detyrime të tjera financiare në lidhje me aktivitetin e tij/saj ekonomik në lidhje me taksat (duke përfshirë taksën e tokës, ose taksën mbi pronën – ndërtesën ku zhvillohet aktiviteti ekonomik) detyrimet e

siguracioni (shëndetësore dhe shoqërore), në rast se aplikanti është një person fizik ose juridik (ose SHBB) dhe

- Të mos kenë detyrime financiare të prapambetura ndaj MBZHRAU-së dhe strukturave në varësi të saj (duke përfshirë AZHBR) dhe
- Të mos kenë përfituar grante (fonde publike) në pesë vitet e fundit për të njëjtin investim për të cilin ai/ajo po aplikon në kuadrin e skemës së grantit SARED.

## 2.2.4 Kriteret e pranueshmërisë në lidhje me investimet

- Kapacitetet e pranueshme akomoduese për çdo aplikant duhet të jenë deri në 16 shtretër për një fermer individual, dhe deri në 25 shtretër për një biznes (biznes i vogël dhe i mesëm). Duhet garantuar hapësirë e veçuar jetese për turistët.
- Kapaciteti i godinave të tjera si për shembull një kafene apo një restorant për të qënë të pranueshëm duhet të jetë nga 10 deri në 30 persona.
- Investimi kur të përfundojë duhet të respektojë standardet përkatëse vendase në fushën përkatëse në përputhje me akomodimin, sigurinë ushqimore, dhe mbrojtjen mjedisore.
- Në rastet e investimeve në energjinë e rinovueshme (në fermë), të pranueshme janë vetëm pajisjet me një kapacitet për konsum vetjak të energjisë që lidhen me aktivitetin ekonomik të fermës së tij/saj ose të biznesit për turizmin rural.
- Punimet e ndërtimit, materialet dhe metodat duhet të respektojnë karakteristikat dhe kërkesat kulturore, arkitektonike, dhe traditën për qarkun përkatës dhe duhet të çertifikohen nga institucionet rajonale përkatëse vendasesiç kërkohet nga legjislacioni shqiptar, si dhe standardet e ndërtimit dhe kërkesat sipas legjislacionit shqiptar për ndërtimin.
- Mobilimi duhet të jetë në përputhje me karakteristikat tradicionale të qarkut (jo luksoz).
- Të gjitha projektet e dorëzuara për të qënë të pranueshme për mbështetje duhet të jenë në përputhje me standardet përkatëse të fushës në fund të investimit dhe në fillim të KpP-së.
- Projektet e investimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e planeve të menaxhimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ose zonave të mbrojtura dhe si të tilla duhet të jenë të përshatshme për territorin ku zhvillohet investimi.
- Në rastet kur në territore të caktuara ekzistojnë strategji lokale të zhvillimit, projekt-propozimi duhet të ketë miratimin e Grupit Lokal të Veprimit (LAG) ashtu siç është miratuar nga MBZHRAU-ja.

## 2.3 Kushtet Financiare të Projekteve për Investime të Pranueshme

### 2.3.1 Minimumi dhe Maksimumi i investimevetë pranueshme

Në këtë kuadër, totali i investimevetë pranueshme për të cilat mund të kërkohet një grant duhet të përfshijësi investimet në fermë ashtu edhe ato jashtë ferme midis shumave të mëposhtme minimale dhe maksimale:

- shuma **minimale** e totalit të investimeve të pranueshme: 400,000 ALL
- shuma **maksimale** e totalit të investimeve të pranueshme: 5,000,000 ALL

### 2.3.2 Intensiteti i ndihmes (Shuma maksimale e grantit)

Intensiteti i ndihmës (madhësia e grantit) përllogaritet vetëm mbi bazën e “shpenzimeve të pranueshme” (kostot e pranueshme). Kostot e tjera të renditura si “shpenzime të papranueshme” nuk merren parasysh në përllogaritjen e vlerës së grantit që do të paguhet përfituesve.

- i. Për investimet **në fermerë kryera nga aplikantët me statusin e një fermieri në kuadrin e ZV 4, madhësia e grantit është 65%** e totalit të shpenzimeve të pranueshme (kostove) të investimit të pranueshëm të realizuar.
- ii. Për investimet **jashtë fermerë kryera nga operatorët e biznesit në kuadrin e ZV 4, madhësia e grantit është nga 50% deri në 60%** e totalit të shpenzimeve të pranueshme për investimet e realizuara dhe të detajuara si vijon:
  - **Intensiteti bazë i ndihmës (madhësia e Grantit)**, për të gjithë aplikantët në këtë kategori **është 50 %** e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit të pranueshëm të realizuar.
  - **Kësaj shume do t'i shtohen 10 %** e shpenzimeve të pranueshme në rast se investimi i pranueshëm zbatohet nga një aplikant i ri (në moshën nën 40 vjet në momentin e dorëzimit të aplikimit) **OSE** një grua (*përfaqësuese individuale ose ligjore e një biznesi privat të rregjistruar*).

### 3. Rregullat për shpenzimet e pranueshme

Dy kategoritë e kostove (shpenzimeve) të konsideruara si (i) të pranueshme dhe(ii) të papranueshme shpjegohen me detaje më poshtë.

Për të qënë të pranueshme në kuadrin e skemës së grantit, shpenzimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Kontratës së Grantit të firmosur. Modeli i Kontratës së Grantit botohet në faqen e internetit të MBZHRAU-së: [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al)

Aplikantët duhet të kenë parasysh se shpenzimet e pranueshme duhet të bazohen në kosto dhe çmime reale dhe duhet të jenë të faktuara me anë të dokumentave mbështetëse të cilat duhet të dorëzohen siç kërkohet në formularin e KpP-së. Në këtë aspekt, kontrollet e kryera nga Autoriteti Kontraktues mund të sjellin nevojën për sqarime nga aplikantët, dhe mund të imponojnë modifikime të cilat mund të çojnë në reduktime të rimbursimit për të trajtuar dhe korrigjuar ndonjë gabim, neglizhencë apo kosto joreale.

#### 3.1 Shpenzimet e Pranueshme në kuadrin e ZV 3

Për përlogaritjen e shumës së grantit merren në konsideratë vetëm “shpenzimet e pranueshme”

Kostot e pranueshme (shpenzimet) e kryera nga përfituesit **duhet të përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme:**

- 1) Të jenë kosto që janë të nevojshme për zbatimin e investimit bazuar në Listën e Shpenzimeve/Investimeve të Pranueshme (Shtojca 3 e UpA) dhe të shpjeguar në buxhetin e detajuar të kontratës së grantit;
- 2) Të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme, të arsyeshme, të justifikuar dhe në përputhje me kërkesat e një menaxhimi të shëndoshë financiar, veçanërisht në lidhje me ekonominë dhe eficientësinë.
- 3) Çdo pagesë që lidhet me blerje makinerish/pajisjesh, punime ndërtimi, apo blerje shërbimesh këshillimore duhet të dokumentohet nga aplikantët nëpërmjet faturave origjinale të lëshuara nga furnitorë apo ofrues të regjistruar të shërbimeve siç kërkohet nga legjislacioni shqiptar në përputhje me statusin e tyre ligjor.
- 4) Të jenë kosto që lidhen me blerjen e makinerive dhe pajisjeve të reja deri në vlerën e tregut të asetit.
- 5) Të jenë kosto që janë bërë dhe disbursuar gjatë periudhës së zbatimit të Projektit të Investimit (pas firmosjes së kontratës me GIZ, me përjashtim të kostove të përgjithshme). Periudha e zbatimit të investimit (datat e fillimit dhe përfundimit të tij) do të parashikohet në kontratën e grantit të firmosur midis aplikantit dhe Autoritetit Kontraktues. Për këtë arsye, projekti i investimit nuk mund të fillojë pa u firmosur kontrata midis përfituesit dhe



GIZ, dhe nga ana tjetër kontratat midis aplikantit dhe furnitorëve apo ofruesve të shërbimit nuk mund të lidhen para datës së firmosjes së kontratës me autoritetin kontraktues të GIZ-it (me përjashtim të kostove të përgjithshme që lidhen me përgatitjen e dosjes së aplikimit).

- 6) Te jenë kosto që lidhen me ndërtimin dhe rikonstruksionin/zgjerimin/përmirësimin pronave të paluajtshme. Në këtë rast:
- Punimet e ndërtimit duhet të kryhen nga një palë e tretë e kontraktuar (person fizik ose juridik i regjistruar). Puna e vetë fermerit dhe e të afërmeve të tij/punëtorëve të sipërmarrjes është kosto e papranueshme.
  - Punimet e mirëmbajtjes rutinë të ndërtesave dhe godinave nuk janë të pranueshme. Mirëmbajtje rutinë do të thotë shërbime që kryhen sipas një plani sistematik dhe që kanë për qëllim të zgjasin jetën e përdorimit të një ndërtese dhe të reduktojnë nevojën për riparime madhore.
- 7) **Të jenë kosto të përgjithshmetë** cilat duhet të planifikohen në planin e biznesit dhe që lidhen me shpenzime që i referohen investimit dhe që bëhen kryesisht për qëllime të përgatitjes së dosjes së aplikimit (para datës së aplikimit) dhe lidhen me këshillimin për zbatimin e investimit dhe përgatitjen e KpP-së si:
- pagesa për këshilluesit për përgatitjen e dosjes së aplikimit, përgatitjen e planit të biznesit, kostot e përkthimit zyrtar të dokumenteve për dorëzimin e aplikimit,
  - përgatitja e planit të projektit (projekti arkitekturor, projekti i ndërtimit, preventivi i shpenzimeve, projekti teknologjik, projekti elektrik, projekti inxhinierik ...) arkitektët, inxhinierët, topografet, dhe
  - kosto të tjera për konsulencë për studime fizibiliteti, përgatitje të strategjive të marketingut që lidhen ngushtë me investimin,
  - kostot e marrjes së licencave the acquisition of licenses,
  - kostot për konsulentët për të orientuar dhe këshilluar përfituesin në lidhje me zbatimin e saktë të investimit të pranueshëm, duke përfshirë përgatitjen e KpP-së.
  - Shuma totale e kostove të përgjithshme të pranueshme** është deri në një tavan prej 12 % të shpenzimeve totale të pranueshme, duke përfshirë edhe kostot për përgatitjen e planit të biznesit deri në një tavan prej 4% të shpenzimeve totale të pranueshme, por me një maksimum prej 200,000 ALL.
  - Kostot e përgjithshme të përmendura më sipër duhet të faktohen me faturë origjinale të lëshuar nga ofruesit e të mirave dhe shërbimeve të regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, bazuar në kontratat e firmosura midis aplikantit dhe ofruesit të shërbimit (konsulet) para datës kur aplikanti dorëzon dosjen e aplikimit.

### 3.2 Investime dhe Shpenzime të Papranueshme

Në kuadrin e të 3 Zinxhirëve të Vlerave, **investimet/shpenzimet e mëposhteme** nuk do të merren parasysh në perlllogaritjen e masës së grantit:

- Projektet ku produkti përfundimtar nuk është në listën e shpenzimeve të pranueshme paraqitur në Shtojcën 3;
- Projektet/investimet e financuara nga burime të tjera publike për të njëjtat investime; kostot e të njëjtit investim të mbuluara nga një tjetër projekt i financuar nga një program kombëtar apo donator;
- Kosto që lidhen me blerjen e pajisjeve/materialeve të ndërtimit dhe të tjera të dorës së dytë;
- Projekte për të zëvendësuar pajisje të financuara nga granti në 5 vitet e mëparshme;
- Projekte/investime të filluara dhe shpenzime të kryera para firmosjes së kontratës së Grantit me autoritetin kontraktues (GIZ-SARED), me përjashtimin e kostove të përgjithshme sic përcaktohet në pjesën 3.1;

- Të gjitha llojet e kontributeve si për shëmbull puna e aplikantit, punëmarrësit e tij/saj ose të afërmit e tij/saj;
- Punimet e mirëmbajtjes rutinë të ndërtesave dhe godinave nuk janë të pranueshme. Mirëmbajtje rutinë do të thotë shërbime që kryhen sipas një plani sistematik dhe që kanë për qëllim të zgjasin jetën e përdorimit të një ndërtese dhe të reduktojnë nevojën për riparime madhore;
- Kostot e blerjes, marrjes me qera apo dhënia në përdorim e tokës dhe godinave ekzistuese dhe marrja me qera/dhënia në përdorim e makinerive /paisjeve;
- Blerja, marrja apo dhënia për shfrytëzime kafshëve për aktivitete turistike;
- Kostot e operimit (si mallrat e konsumit, shërbimet dhe furnizimi me karburant – energji elektrike, ujë, naftë, gaz, etj.), kostot e mirëmbajtjes, amortizimit dhe qirasë;
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për aplikantët që janë regjistruar si persona fizikë ose juridikë të kategorizuar nga sistemi tatimor në fuqi si pages të TVSH-s;
- Taksate tjera;
- Tarifat doganore dhe të importit dhe çdo detyrim tjetër;
- Çdo kosto e ngarkuar nga administrata publike në menaxhimin dhe dhënien e shërbimeve;
- Kostot e këmbimit të monedhes, detyrimet dhe humbjet nga këmbimi valutë, si dhe shpenzimet e tjera thjesht financiare;
- Kosto të rifinancimit të interesave, shpenzimet dhe tarifat e siguracionit;
- Gjokat, penaltetet financiare dhe shpenzimet e proceseve gjyqësore;
- Detyrimet bankare, kostot e garancive dhe detyrimet e ngjashme;
- Borxhet dhe përqindjet e interesave të borxhevenga humbjet ose detyrimet potenciale të ardhshme;

#### 4. Objektivat specifike të investimeve të pranueshme nëkuadrin e ZV 4 – Turizmi Rural

Ju lutemi, referojuni Shtojcës 3 të UpA-së, ku jepen detajet të investimeve që janë të pranueshme në kuadrin e kësaj Skeme grantesh.

Një aplikim mund të synojnë **një ose më shumë objektiva të një Zinxhiri Vlere dhe të përfshijë një ose më shumë lloje investimi brenda të një zinxhiri vlere** të renditur në Shtojcën 3 të UpA-së tëskemës së granteve SARED.

Modernizimi i akomodimit dhe i godinave të shërbimit për turistët në përputhje me kërkesat ligjore vendase.

Përmirësimi i standardeve në fushën e akomodimit dhe shërbimeve për turistët, duke përfshirë mbrojtjen/ruajtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore dhe cilësinë, shëndetin dhe mirëqënien e kafshëve.

Të pranueshme për mbështetje janë projektet e investimit që synojnë objektivat specifike të mëposhtëm:

- Përmirësimi i kapaciteteve akomoduese, teknikave dhe teknologjive bazuar në karakteristikat tradicionale të qarkut;
- Përmirësimi i godinave dhe pajisjeve për akomodimin dhe argëtimin e turistëve dhe për përgatitjen dhe servirjen e ushqimit në përputhje me standardet përkatëse që zbatohen në sektorin e turizmit vendas dhe në vecanti në lidhje me akomodimin, përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimit, standardet e higjenes, etj;

- Përmes mbështetjes së investimeve, synohet prezantimi i sigurisë ushqimore dhe sistemeve të cilësisë në përgatitjen e ushqimit/godinat e shërbimit (kuzhinë, bar-restorante, etj).

## 5. Procedura e Aplikimit

### 5.1 Thirrja për aplikime

Aplikantët do të ftohen për të paraqitur aplikimet e tyre përmes një thirrje të hapur për aplikime, e cila do të bëhet publike përmes njoftimeve të publikuara në mediat kombëtare dhe lokale dhe në faqen e internetit të MBZHRAU-t [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al).

Kujdes, informacioni i sakte mbi thirrjet për aplikime, kohëzgjatjen e secilës nga thirrjet për aplikime si edhe afatet brenda të cilave mund të paraqiten aplikimet do të përcaktohen në **njoftimin për thirrjen për aplikime** që do të publikohet në gazetën kombëtare por do të publikohet edhe në faqen e internetit të MBZHRAU [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al).

### 5.2 Kritere për dorëzimin e Aplikimeve

- Aplikimet në lidhje me ZV 4 duhet të dorëzohen nga vetë personi vetëm në zyrat rajonale të SARED në Kukës, Peshkopi, dhe në Berat.
- Do të pranohen vetëm aplikime të dorëzuara në përputhje me afatin e specifikuar në Thirrjen për Aplikime.
- Dosjet e aplikimit duhet të dorëzohen në një kopje në një zarf (1 dosje origjinale), të renditura sipas radhës që specifikohet në PJESA 5 “LISTA E DOKUMENTAVE MBËSHTETËSE/SHOQËRUESE”, të Formularit të Aplikimit.
- Në zarf aplikanti duhet të shkruajë emrin e tij të plotë dhe adresën (kontaktet), titullin e projektit (investimit) dhe ZV-në përkatëse.
- Numri i aplikimeve të suksesshme të një aplikanti në kuadrin e “SARED” është i kufizuar në 1.
- Autoriteti Kontraktues (GIZ) ka të drejtën e pronësisë së të gjitha aplikimeve të marra. GIZ-i mund të vendosë bazuar në një kërkesë të shkruar nëse aplikantët kanë të drejtë t’ju kthehen mbrapsht aplikimet origjinale të tyre.

### 5.3 Përmbajtja e dosjes së Aplikimit

**Dosja e aplikimit duhet të jetë në gjuhën shqipe (përkatësisht e përkthyer).** Në rastin kur dokumentat mbështetës nuk janë në gjuhën shqipe (furnitorët nga jashtë vendit) atëherë bëhet një perkthim zyrtar në gjuhën Shqipe dhe i bashkëngjitet dokumentit origjinal.

Aplikantët duhet të paraqesin dosjen e Aplikimit që përmban:

(a) Formularin e aplikimit, (Shtojca 1 e UpA-së)

(b) Të gjithë dokumentet mbështetës, të renditur siç kërkohet në formularin e Aplikimit) dhe

(c) Planin e Biznesit

#### Shpjegime të Mëtejshme në lidhje me;

- (a) **Formulari i Aplikimit – Shtojca 1.** Ju lutemi paraqisni formularin e aplikimit në versionin e plotësuar në kompjuter dhe të printuar origjinal dhe të firmosur nga aplikanti.
- (b) **Dokumentet mbështetëse** që kërkohen në formularin e Aplikimit (shiko Shtojcën 1 të Udhëzuesit për Aplikantët)
  - Aplikanti duhet të dorëzojë në dosjen e aplikimit së bashku me formularin e aplikimit edhe të gjitha dokumentet mbështetëse, që kërkohen dhe që paraqiten në listën e

Formularit të Aplikimit, Pjesa 5 e Shtojcës1 të UpA-s, si provë për të vërtetuar se ai apo ajo i plotëson të gjitha kriteret e pranueshmërisë që lidhen me investimin.

- Në rastin kur Formulari i Aplikimit kërkon “Kopje” të dokumenteve, këto kopje të dokumentave duhet të jenë të qarta, lehtësisht të lexueshme dhe identike me origjinalet dhe aplikanti duhet të konfirmojë këtë nëpërmjet vetëdeklarimit i cili duhet dhënë në formularin e aplikimit. Me këtë aplikanti merr përsipër përgjegjësinë mbi vërtetësinë e dokumentave të dorëzuar.
- Aplikanti duhet të ruajë një dosje per veten e tij në fermën/stabilimentin ku ruan edhe të gjitha dokumentet origjinale, sepse ato do të kërkohen dhe krahasohen me kopjet e dorëzuara për të vërtetuar origjinalitetin e kopjes gjatë kontrollit në vend. Në rast të mospërputhjeve, aplikimi mund të refuzohet ose përkatësisht do të refuzohet pagesa për grantin. Dokumentat origjinalë duhet të përmbajnë të gjithë elementët që kërkon legjislacioni shqiptar (si psh. vula, nënshkrime, protokollin, etj).

### (c) Plani i Biznesit:

- Për investimet deri në 1,400,000 lekë, ju lutemi përdorni formularin model të Planit të Biznesit ofruar në Shtojcën 2/1, i cili konsiston vetëm në një Plan Biznesi të thjeshtë pershkrues/narrativ;
- Për investime mbi 1,400,000 lekë, ju lutemi përdorni formularin model të Planit të Biznesit ofruar në Shtojcën 2/2, i cili konsiston në dy pjesë, një narrative dhe njëfinanciare:
  - **Pjesa narrative** e Planit të Biznesit duhet të përgatitet duke përdorur modelin e dhënë në **Shtojcën 2/2/1** dhe duhet të dorëzohet e printuar në letër në versionin origjinal;
  - **Pjesa Financiare** e Planit të Biznesit duhet të përgatitet duke përdorur modelin e dhënë në **Shtojcën2/2/2** dhe duhet të dorëzohet në versionin e printuar dhe në atë elektronik (CD-Rom)
  - (Llogaritjet e bëra në versionin elektronik të pjesës financiare të Planit të Biznesit dërguar në CD-ROM do të verifikohen)

Ju lutemi që të përgatitet një PB sa më i plotë, ndiqni me kujdes udhëzimet mbi përgatitjen e PB-së që jepen në Shtojcën 2.3 të kësaj UpA-je.

**Së bashku me PB-në dhe formularin e Aplikimit, aplikantët duhet të paraqesin 3 oferta origjinale** për çdo shpenzim që lidhet me projektin e investimit dhe që është më i lartë sesa 140,000 Lek (vlera totale e faturës).

### **Kërkesat në lidhje me ofertat janë si më poshtë:**

Të trija ofertat duhet të jenë lehtësisht të krahasueshme, për këtë arsye:

- i. Aplikanti për këtë përgatit specifikimet teknike neutrale për secilin zë të investimit për të cilin ai aplikon në Skemën e Grantit SARED
- ii. Aplikanti kërkon 3 oferta nga 3 furnitorë të ndryshëm bazuar në të njëjtat specifikime teknike neutrale (si më sipër) për secilin mall/shërbimtë investimit, preventiv, projekt për punime ndërtimi/rikonstruksioni ku ofertat e bëra nga ofruesit duhet të përmbajnë elementet e mëposhtme:
  - a. Në rastin e investimeve nëpajisje, përvec specifikimeve teknike të kërkuara nga aplikanti, ofertat duhet të përmbajnë elementet si psh tipi, modeli, kapaciteti/fuqia e motorrit si edhe karakteristika të tjera thelbësore për paisjen/makinerinë;
  - b. Në rastin e investimit në ndërtim/rikonstruksion, ofertat duhet të bazohen mbi të njëjtat specifikime teknike të preventivit dhe në përlllogaritjen përkatëse të kostos “fatura e sasisë”.

Ofertat/faturat nga furnitorët e huaj/ofruesit e shërbimeve jashtë Shqipërisë duhet të leshohen mundësisht në gjuhën angleze. Aplikanti duhet t'i bashkëngjisë dokumentave origjinale një **përktim zyrtar në gjuhën shqipe**.

Ofertat/faturat nga furnitorët/ofruesit e shërbimeve në Shqipëri duhet të lëshohen në gjuhën Shqipe dhe në monedhën Shqiptare (Lek).

Furnitorëve nga Shqipëria iu kërkohet të dorëzojnë ekstraktin e thjeshtë të regjistrimit të lëshuar nga QKB-ja. Furnitorët/ofruesit e shërbimeve të cilët janë ftuar të paraqitin tre oferta për të gjitha shpenzimet që lidhen me investimin dhe që janë në vlerën mbi 140,000 lekë, nuk duhet të kenë lidhje fafeshnore dhe ose biznesi me njëri-tjetrin apo me aplikantin (me lidhje fafeshnore këtu kuptohen anëtarët e ngushtë të familjes dhe më ekzaktesisht bashkëshorti, bashkëshortja, babai, nëna, vëllai, motra, kunati, kunata).

Furnitorëve nga jashtë Shqipërisë iu kërkohet që në ofertë, përveç elementëve themelorë që duhet të përmbajë oferta e tyre siç kërkohet në paragrafin më poshtë, të bëjnë një deklaramë me përmbajtjen si vijon;

- Kompania ofertuese ka një biznes në status aktiv në fushën e biznesit që lidhet me ofertën, dhe
- Ata nuk kanë lidhje fafeshnore me aplikantin (me lidhje fafeshnore këtu kuptohen anëtarët e ngushtë të familjes dhe më ekzaktesisht bashkëshorti, bashkëshortja, babai, nëna, vëllai, motra, kunati, kunata) dhe
- Nuk kanë lidhje biznesi me aplikantin.

Gjithsesi, GIZ-i ka të drejtë të kërkojë nga aplikanti që të dorëzojë ekstraktin nga regjistri për furnitorët nga jashtë gjatë procesit të vlerësimit.

Në rastin kur verifikohen lidhjet e përmendura më lart ndërmjet aplikantit dhe njërit nga ofertuesit apo përfaqësuesit ligjorë të tij, atëherë kërkohet një ofertë e re.

**Elementet kryesore që kërkohen të përmbahen në formatin e ofertave paraqiten më poshtë;**

- Data e lëshimit;
- Emri i furnitorit;
- Numri i regjistrimit të furnitorit në QKR;
- Çmimi, TVSH-ja dhe taksa të tjera të paraqitura veç e veç dhe bazuar në:
  - Specifikimet e detajuara teknike që ka derguar aplikanti duke shtuar edhe specifikime të tjera specifike si tipi, modeli, etj;
  - Faturën e sasive me çmimet për njësi në rastin e përlllogaritjes së kostos së punimit dhe ndërtimit;
  - Vendin e dorëzimit të mallit
- Vlefshmëria e ofertës;
- Nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor dhe vulën, aty ku është e aplikueshme;
- Një deklaramë si pjesë e ofertës që konfirmon se çmimi i ofruar i referohet paisjeve, makinerive të reja, etj.

Ofertat duhet të jenë në origjinal dhe të vlefshme për kohën kur planifikohet të kryhet investimi.

Në rast se ndonjë nga ofertat e paraqitura është e fallsifikuar dhe e lëshuar me qëllim përfitimi të pamërituar, një aplikim i tillë duhet të refuzohet.

Aplikanti bën krahasimin e tre ofertave bazuar në tabelën e krahasimit të ofertës në Planin e Biznesit (Shtojca 2.1 dhe 2.2.1).

Nëse nuk zgjidhet oferta me vlerën më të ulët/ekonomike, aplikanti duhet të japë një arsyetim/justifikim të shkruar.

Në tabelën e krahasimit, të gjitha vlerat në oferta apo fatura duhet të shënohen në Lek apo të përlllogariten në Lek. Për ato oferta/fatura që lëshohen në valutë të huaj nga furnitorët/kompanitë e huaja, llogaritja e vlerave nga monedha e huaj në lekë bëhet me kursin e këmbimit të muajit në të cilin është hapur thirrja për aplikime ose në lidhje me

Kërkesën për Pagesë të muajit në të cilin dorëzohet Kërkesa për Pagesë. Shumat korrekte për të cilat bëhet aplikimi për kontraktim apo për kërkesën për pagesë aplikanti duhet t'i paraqesë në tabelën përkatëse të dhënë në formularin e aplikimit dhe ose formularin e kërkesës për pagesë.

Aplikanti duhet të përdorë kursin këmbimit që gjendet në këtë adresë:

[http://ec.europa.eu/budget/contracts\\_grants/info\\_contracts/infoeuro/infoeuro\\_en.cfm](http://ec.europa.eu/budget/contracts_grants/info_contracts/infoeuro/infoeuro_en.cfm)

#### A. **Faturat**

Ne rastin kur aplikanti ka kryer **pagesa** që lidhen me kategorinë e kostove të përgjithshme, të cilat kryen para se aplikanti të firmosë kontratën me GIZ-in, aplikantidorëzon të mëposhtmet:

1. Ne rastin kur vlera totale e faturës nuk e kalon shumën 140,000 Lek aplikanti dorëzon
  - i. vetëm faturën origjinale lëshuar nga ofruesi i shërbimeve/ furnitori i mallit sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar ne perputhje me statusin biznesit te tij.
2. Në rastin kur vlera totale e faturës e kalon shumën 140,000 Lek aplikanti dorezon
  - i. kontratën e nënshkruar ndërmjet aplikantit dhe ofruesit të shërbimit si edhe
  - ii. faturën origjinale të lëshuar sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar ne perputhje me statusin biznesit te tij.

Nëse aplikanti nuk dorëzon dokumentin e kërkuar në afatin e përcaktuar, dosja e aplikimit do të refuzohet.

#### 5.4 **Përzgjedhja dhe Renditja e Aplikimeve**

Të gjitha aplikimet do të mblidhen dhe renditen në përfundim të afatit të thirrjes për aplikim ne baze bashkie dhe NjAQV.

Renditja do të kryhet bazuar në kriteret e renditjes si mëposhtë:

<b>Kritere për renditjen</b>	<b>Pikët</b>
Vende pune shtesë të krijuara që shpjegohen në PB	30
Aplikanti është grua ose burrë nën 40 vjeç	20
Investimi është në përputhje me traditën e qarkut dhe kulturën për sa i përket akomodimit dhe përgatitjes/ servirjes së ushqimit	25
Eksperienca profesionale në turizëm e shpjeguar në PB për fermerë individualë ose përmes licensave për bizneset e vogla dhe të mesme	15
Investimi po prezanton energjinë e rinovueshme ose elementë të përdorimit me efikasitet të enegjisë	10
<b>Pikët totale</b>	<b>100</b>

Aplikimet e pranueshme që janë marrë do të renditen sipas pikëve të grumbulluara bazuar në tabelën e renditjes të mësipërme. Vija ndarëse do të vendoset bazuar në buxhetin në dispozicion, dhe aplikimet e renditura sipër kësaj vije do të financohen. Për më tepër, do t'i jepet prioritet dy aplikimeve me pikët më të larta nga çdo NjAQV në Bashkinë përkatëse.

Në rast se ka dy ose më shumë aplikime me numër të njëjtë pikësh, atëherë mes tyre do të përdoret parimi i datës dhe kohës së dorëzimit të aplikimit në zyrat rajonal, "Parimi kush vjen i pari e përfiton shërbimin i pari". Data dhe koha regjistrohen në protokollin e zyrës rajonale të SARED-it.

Në rast se pas kontraktimit të aplikimeve të renditura ka ende një pjesë buxheti në dispozicion, procesi i kontraktimit do të vazhdojë me aplikimet në vijën ndarëse në listën e pritjes sipas renditjes.

Nese ne nje NjAQV apo bashki nuk ka aplikime apo ka nje numer te vogel dhe buxheti orientues nuk perdoret atehere buxheti i mbetur transferohet per ato NjAQV apo Bashki ku ka nje numer te larte aplikimesh.

## 6. Shënime të rëndësishme në lidhje me pranueshmërinë/refuzimin e Aplikimeve

Në qoftë se disa prej kërkesave formale të përcaktuara më sipër nuk respektohen plotësisht, reagimi do të jetë proporcional në raport me gabimete identifikuar dhe nuk do të pegojë në trajtimin e barabartë të aplikantëve potencialë.

### 6.1 Refuzimi për gabime madhore

Aplikimi **do të refuzohet** pa kërkuar dorëzimin/ridorëzimin e dokumenteve në rast të gabimeve të mëposhtme madhore:

- Dorëzimi i aplikimit pas afateve të njoftuar apo pas përfundimit të fondeve të skemës së grantit SARED;
- Mosparaqitja e formularit të aplikimit;
- Mosdorëzimi i planit të biznesit;
- Mospërdorimi i modelit standard të formularit të aplikimit apo planit të biznesit. Ato janë dorëzuar, por jo sipas modeleve standarde të dhëna;
- Plotësimi me shkrim dore i formularit të Aplikimit apo planit të biznesit;
- Mosshoqërimi i formularit të Aplikimit me dokumente mbështetëse;
- Mosparaqitja e ofertave;
- Dorëzimi nga i njëjti aplikant i dy aplikimeve në të njëjtën kohë në përgjigje të thirrjes për propozime.
- Aplikanti ka aplikime që nuk janë paguar ende;
- Aplikanti e ka marrë më parë sasinë maksimale të mbështetjes;
- Aplikanti figuron debitor ndaj MBZHRAU-së;
- Investimi nuk është në përputhje me Listën e shpenzimeve të pranueshme (Shtojca 3).

### 6.2 Kërkesa për ridorëzimin e dokumenteve për gabime të vogla

Në rastet e gabimeve të vogla paraqitur më poshtë, personeli i GIZ-it do të kërkojë **sqarime/ridërgim të dokumenteve që mungojnë**:

- Formulari i Aplikimit dhe pjesa Narrative e Planit të Biznesit është paraqitur sipas modelit korrekt dhe është ofruar informacioni i kërkuar, por mënyra në të cilën është plotësuar dokumenti nuk është e qartë ose mungojnë disa të dhëna;
- Dosja/ deklaratat e aplikimit apo ndonjë dokument tjetër nuk është firmosur ose përmban një firmë të skanuar.
- Mungon një pjesë e dokumenteve mbështetëse të kërkuara në formularin e aplikimit;
- Një dokument i ka mbaruar afati i vlefshmërisë dhe nuk përmbush kërkesat e Formularit të aplikimit (çertifikata, oferta, etj.);
- Totali i kostove të pranueshme është më i ulët ose më i lartë sesa limiti i përcaktuar në Udhëzuesin për Aplikantët;

## **Para nënshkrimi të kontratës siç parashikohet në Udhëzuesin për Aplikantët, do të bëhen korrigjimet e mëposhtme:**

- Është ofruar informacioni i kërkuar në formularin e aplikimit dhe në pjesën narrative të planit të biznesit, por dokumentet nuk janë plotësuar në mënyrë korrekte, p.sh. informacioni është ofruar në seksionin X të formularit model, ndërkohë që duhet të ofrohej në seksionin Y;
- Korrigjohen gabimet aritmetike;
- Hiqen zërat / kostot e papranueshme;
- Nëse janë tejkalluar kufijtë e kostove të përgjithshme apo të planit të biznesit, kostot reduktohen nga personeli i SARED-it;
- Sasia e grantit do të reduktohet nëse aplikanti kërkon një sasi (%) më të lartë granti sesa është përcaktuar.

### **6.3 Raste të tjera**

#### **Në të gjitha rastet e tjera që nuk parashikohen shprehimisht më sipër, MBZHRAU-ja dhe GIZ-i do të marrin vendim rast pas rasti, duke garantuar që vendimi të respektojë**

- Parimin e trajtimit të barabartë të aplikuesve
- Parimin e proporcionalitetit.

Aplikantit do t'i jepet deri në 20 ditë pune afat për të dërguar dokumentet që mungojnë dhe nëse dokumentet nuk dërgohen brenda këtij afati apo dërgohen të paplota, aplikimi nuk do të pranohet.

### **7. Kontrollat në vend perpara firmosjes së kontratës**

Aplikimet që janë në përputhje me rregullat administrative dhe të pranueshmërisë do të verifikohen në terren për të parë nëse informacioni i paraqitur në formularin e aplikimit është i saktë.

Kontrolli në Vend do të kryhet nga koordinatorët rajonalë të GIZ-it dhe stafi i MBZHRAU-së në qarqe (stafi shtesë, etj.) dhe sipas nevojës nga Autoritetet Kombëtare dhe ekspertët afatshkurtër të kontraktuar nga GIZ-i në fushat përkatëse të investimit, të cilët do të verifikojnë informacionin përkatës në lidhje me kriteret e pranueshmërisë dhe përmbushjen e standardeve kombëtare minimale të projektit të planifikuar të investimit.

Kontrolli i detyrueshëm në Vend para kontraktimit bëhet vetëm për investimet në ndërtim, rikonstruksion (jo për makineri dhe pajisje të reja të lëvizshme) si edhe në çdo rast investimi për të cilin Autoriteti kontraktues vendos se është i nevojshëm të kryhet. Gjatë kontrolleve në terren do të kontrollohen dokumentet origjinale dhe asetet.

Në qoftë se nga kontrollat në vend konstatohet se aplikanti apo projekti i investimit nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë që përcaktohen në Udhëzuesin për Aplikantët, aplikimi do të refuzohet edhe mbi vetëm këtë bazë.

### **8. Njoftimi i Aplikantëve në lidhje me marrjen e vendimit**

Aplikantët do të informohen me shkrim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aplikimin e tyre;

Në rast vlerësimi/vendimi pozitiv, aplikanti do të ftohet që të nënshkruajë kontratën, kurse në rast refuzimi, Autoriteti Kontraktues (GIZ) i informon ata mbi arsyet e vendimit negativ.



## 9. Kontrata për dhënien e grantit

Pas vendimit të Autoritetit Kontraktues për dhënien e grantit, përfituesit do t'i ofrohet kontrata e grantit. Në mënyrë që aplikantët të familjarizohen me përmbajtjen e Kontratës së Grantit, Autoriteti Kontraktues do të vërë në dispozicion për ta një model të Kontratës së Grantit në faqen e internetit të MBZHRAU-së [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al).

Përfituesi potencial do të marrë një Njoftim për Vendimin për Dhënien e Grantit, përmes të cilit Përfituesi do të ftohet për të ardhur dhe për të firmosur Kontratën brenda një periudhe 10 dite pune nga data në të cilën dërgohet njoftimi nga zyra qendrore.

Kontrata e Grantit do të lëshohet në dy kopje në secilën gjuhë (anglisht dhe shqip), një kopje për Autoritetin Kontraktues dhe kopja tjetër për Përfituesin e Grantit.

Me firmosjen e Kontratës së Grantit, aplikanti deklaron se, nëse i jepet një grant, ai pranon kushtet kontraktuale të parashikuara në Kontratën e Grantit.

Cdo nevojë dhe kërkesë për ndryshim të ndonjë termi të përcaktuar në kontratë përfshirë edhe zerat e investimeve dhe specifikimet e tyre teknike si edhe kohezgjatjen e kontratës duhet të paraqitet me kërkesë me shkrim për amendim kontratë nga ana e aplikantit e cila paraqitet përpara skadimit të afatit të kontratës por amendimi është i vlefshëm pasi miratohet dhe nënshkruhet nga autoriteti kontraktues (GIZ).

## 10. Ankesat

Aplikantët që besojnë se mund të jenë dëmtuar nga një gabim apo një parregullsi gjatë procesit të vlerësimit, mund të paraqesin një ankesë brenda 15 ditë pune nga data e marrjes së vendimit. Ankesa duhet të paraqitet me shkrim në zyrat rajonale ose direkt me postë në zyrën kryesore në Tiranë, firmosur nga aplikanti dhe duke iu referuar arsytimit të vendimit të marrë nga Autoriteti Kontraktues. Pas rivlerësimit të situatës për të cilën është paraqitur një ankesë, Autoriteti Kontraktues do të lëshojë një përgjigje me shkrim.

## 11. Kohëzgjatja e zbatimit të një projekti investimi

- Afatet për zbatimin e investimit dhe/ ose dorëzimin e KpP-së do të përcaktohen në kontratat individuale të cilat do të firmosen ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe përfituesve të mundshëm.
- Aplikanti mund të aplikojë për shtesë/ ndryshim të kontratës në rrethana të caktuara siç përcaktohet në nenin përkatës së kontratës së firmosur.
- Nuk do të ketë asnjë shtesë përtej afateve të sipërpërmendura.

## 12. Vizibiliteti i investimit dhe kontrollet pas financimit

Përfituesi i Grantit është i detyruar që menjëherë pas bërjes së pagesës, në përputhje me masën e investimit të financuar, të vendosë një *logo/plakë shpjeguese* ku thuhet se Projekti i Investimit është financuar nga: Programi Gjermano-Danez "Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Ekonomik Rural në Zonat e Pafavorizuara në Shqipëri" – SARED. Logoja/plaka do të prodhohet dhe dërgohet në vend nga Autoriteti Kontraktues GIZ.

## Kapitulli II Pagimi i Grantit

### 13. Si paguhet Granti?

- Pagesa do të kryhet nga GIZi bazuar në dosjen e kërkesës për pagesë, e cila dorëzohet nga përfituesi pas zbatimit të investimit siç parashikohet në kontratë.
- Granti do të paguhet plotësisht në përfundim të investimit të pranueshëm të kontraktuar.

- Në kuadrin e skemës së grantit “SARED” nuk kryen pagesa paraprakeapo të ndërmjetme.
- Formulari i KpP-së duhet të shkarkohet nga faqja e internetit të MBZHRAU-së.

#### 14. Dorëzimi i Kërkesës për Pagesë (KpP)–Miratimi / Kryerja e pagesës

Pas përfundimit të investimit në përputhje me kontratën, Përfituesi duhet të paraqesë tek Autoriteti Kontraktues dosjen e Kërkesës për Pagesë(KpP).

##### 14.1 Kritere për dorëzimin e KpP-ve

- KpP-të në lidhje me investimet ZV 4 duhet të dorëzohen nga vetë personi vetëm në zyrat rajonale të SARED në Kukës, Peshkopi, dhe në Berat.
- Do të pranohen vetëm KpP të dorëzuara në përputhje me afatet e specifikuar në kontratën e firmosur midis GIZ-it dhe përfituesit.
- Dosja e Kërkesës për Pagesë duhet të dorëzohet personalisht dorazi në zyrën përkatëse rajonale sipas modelit zyrtar të formularit të Kërkesës për Pagesë (shikoni Shtojcën 5). Ajo duhet të dorëzohen nëdy kopje në një zarf (1 dosje origjinale dhe 1 fotokopje e origjinalit), të renditura sipas radhës që specifikohet në PJESA 5 “LISTA E DOKUMENTAVE MBËSHTETËSE/SHOQËRUESE”, të Kërkesës për Pagesë.
- Në zarf aplikanti duhet të shkruajë emrin e tij të plotë dhe adresën (kontaktet), titullin e projektit (investimit) dhe ZV-në përkatëse.
- Autoriteti Kontraktues (GIZ) ka të drejtën e pronësisë së të gjitha dosjeve të KpP-ve të marra. Rrjedhimisht, përfituesve të grantit nuk do t’u kthehen kërkesat origjinale për pagesë deri kur GIZ-i të vendosë bazuar në një kërkesë të shkruar nëse aplikantët kanë të drejtë t’ju kthehen mbrapsht aplikimet origjinale të tyre (fatura/t origjinale pasi ato të vulosen nga GIZ-i nëse nuk do të qëndrojnë tek GIZ-i).
- Formulari i plotësuar i kërkesës për Pagesë, i cili duhet të shkarkohet nga faqja e internetit të MBZHRAU-së. Formulari i KpP-së nuk duhet të plotësohet me shkrim dore.

##### 14.2 Dosja e KpP-së përmban;

- a) Formularine KpP-së.Në rastin kur Formulari i Kërkesës për Pagesë kërkon “Kopje” të dokumenteve, këto kopje të dokumentave duhet të jenë të qarta, lehtësisht të lexueshme dhe identike me origjinalet dhe aplikanti duhet të konfirmojë këtë nëpërmjet vetëdeklarimit i cili duhet dhënë në formularin e kërkesës për pagesë. Me këtë aplikanti merr përsipër përgjegjësinë mbi vërtetësinë e dokumentave të dorëzuar.

Në kërkesën për pagesë të gjitha kostot duhet të paraqiten në Lekë.Përlllogarita e shumave nga monedha e huaj në Lekë për faturat nga furnitorët e huaj bazohet në kursin e këmbimit të muajit kur u dorëzua kërkesa për pagesë.Kursi i këmbimit është i disponueshëm në adresën e mëposhtme:

[http://ec.europa.eu/budget/contracts\\_grants/info\\_contracts/infoeuro/infoeuro\\_en.cfm](http://ec.europa.eu/budget/contracts_grants/info_contracts/infoeuro/infoeuro_en.cfm)

- b) Të gjitha dokumentet e kërkuara mbështetëse si pjesë të formularit të Kërkesës për Pagesë(shikoni PJESËN – 5 “LISTA E DOKUMENTAVE MBËSHTETËSE”, të formularit të Kërkesës për Pagesë,
- c) Të gjitha faturat origjinale për secilën nga shpenzimet e pranueshme të kryera në lidhje me investimin e miratuar të paraqitur në kontratën e firmosur;

Faturat nga furnitorët e huaj duhet të lëshohen mundësisht në gjuhën angleze ose në shqip dhe aplikanti i bashkëngjit dokumentave origjinale **përkthimin zyrtar në gjuhën Shqipe.**

Faturat duhet të jenë aritmetikisht korrekte, domethënë vlerat në faturë, njësitë dhe specifikimet teknike duhet të përputhen me kontratën e nënshkruar ndërmjet aplikantit dhe autoritetit kontraktues. Faturat duhet të shoqerohen me specifikimet teknike të paisjes apo materialit perkates.

Të gjitha shpenzimet, përveç kostove të përgjithshme, duhen bërë pas firmosjes së Kontratës për Grant me Autoritetin Kontraktues. Kostot për *investimet e kryera në të shkuarën apo para nënshkrimit të Kontratës për Grant, si dhe kostot e tjera të shpenzimeve të parashikuara në kontratë nuk janë të pranueshme në kuadrin e Skemës së Grantit.*

Të gjitha pagesat duhet të jenë kryer nëpërmjet transfertave bankare nga llogaria bankare e perfituesit në llogarinë bankare të furnitorit të të mirave dhe shërbimeve (jo depozitim në kesh në llogarinë bankare të furnitorit), dhe kjo duhet të vërtetohet me deklaratën bankare të datës kur bëhet transfertat. Për të gjitha pagesat e dorëzuara me Kërkesën për Pagesë, kërkohet të dorëzohet nga aplikanti deklarata bankare “bank statement” për të vërtetuar saktësinë e informacionin të dhënë.

Pagesat cash nuk pranohen.

#### **15. Kontrolli në Vend para pagesës**

Kërkesat për Pagesë që janë në përputhje me rregullat administrative dhe ato të pranueshmërisë do të kontrollohen në vend për të verifikuar nëse informacioni i paraqitur në formularin e kërkesës për pagesë është korrekt.

Kontrolli në Vend do të kryhet nga koordinatorët rajonalë të GIZ dhe stafi i MBZHRAU-t në qarqe (stafin e ekstensionit, etj) dhe sipas nevojës nga Autoritetet Kombëtare dhe nga ekspertët afatshkurtër të kontraktuar nga GIZ në fushën përkatëse të investimit, duke verifikuar standardet kombëtare minimale të projektit të planifikuar të investimit.

Kontrolli në Vend para pagesës do të bëhet në 100% të aplikimeve për të kontrolluar që investimi është kryer në përputhje me kontratën dhe është vënë në funksionim, puna është bërë, si dhe nëse pagesat e furnitoreve janë kryer.

Gjatë kontrolleve në vend do të kontrollohen dokumentet origjinale dhe asetet dhe kontrolluesi(t) mund të bëjë fotografi, të masë parcelat e tokës, ndërtesat, etj. Kontrollori mund të mbajë gjithashtu shënime dhe të mbledhë çdo provë tjetër që mund të mbështesë përgjigjet e dhëna në listën e kontrollit.

Në bazë të Raportit të Kontrollit në Vend dhe konstatimit të përputhshmërisë me kontratën, kërkesa për pagesën e grantit miratohet. Në rast të konstatimit të mospërputhjeve, KpP-ja refuzohet ose rishikohet (do të bëhen korrigjime në llogaritjen e shumave të kërkuara).

#### **16. Pagesa e Grantit (kryerja e pagesës)**

Pas miratimit të kërkesës për pagesën, GIZ transferon vlerën e grantit në llogarinë bankare të perfituesit e cila është dhënë në formularin e aplikimit.

Aplikanti mund të kërkojë vetëm me shkrim ndryshimin e numrit të llogarisë që ka dhënë në formularin e aplikimit.

Koha maksimale për kryerjen e pagesës në llogarinë e perfituesit është deri në dy muaj pas datës së dorëzimit të dosjes së plotë të Kërkesës për Pagesë.

## 17. Përmbledhje e disa Shënimeve të Rëndësishme për të gjithë Aplikantët

- Aplikimet mund të përfshijnë vetëm investime në aktive të luajtshme dhe të paluajtshme **përshkruhet në Shtojcën 3 "Lista e Shpenzimeve të Pranueshme" të Udhëzuesit për Aplikantët.**
- Të gjitha makineritë dhe pajisjet e blera **duhet të jenë të reja.**
- Skema e grantit mbështet vetëm investimet që do të zbatohen **pas nënshkrimit të Kontratës së Grantit.**
- **Investimet** që janë ekzekutuar në të kaluarën ose që kanë filluar të zbatohen para nënshkrimit të Kontratës së Grantit **nuk janë të pranueshmenë** këtë Skemë Grantesh.
- **Vetëm pagesat që lidhen me kostot e përgjithshme dhe faturat përkatëse** (shiko pikën 3.1 më lart), që janë realizuar para dërgimit të aplikimit dhe që janë bërë në lidhje me aktivitetet e nevojshme për përgatitjet e projektit të investimit dhe aplikimit janë të pranueshme (konsulentët, përgatitja e planeve të biznesit, projektet teknike, formulari i aplikimit, etj).
- Të gjitha **investimet duhet të jenë në përputhje me standardet minimale kombëtare përkatëse** në lidhje akomodimin dhe pritjen e turistëve, mbrojtjen mjedisore, sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe bimëve dhe sigurinë në punë. Kjo mund të kontrollohet gjatë kontrolleve në vend para lidhjes së kontratës dhe para autorizimit të pagesës nga organet/autoritetet përkatëse që janë në varësi të MBZHRAU-t (Shërbimi Kombëtar Veterinar, Autoriteti Kombëtar për Farat dhe Fidanët dhe/ose Autoriteti Kombëtar i Ushqimit) së bashku me ekspertët e SARED në bazë të formularëve model të raporteve të konfirmimit që përdoren zyrtarisht nga këto organe/autoritete. Autoritetet përkatëse do të kontrollojnë, gjithashtu, nëse sa më poshtë kanë lidhje me investimin:
  - Ndërtesa/godina që është ndërtuar/rikonstruktuar; dhe/ose
  - Ndërtesa/godina ku është instaluar pajisja e sapoblerë; dhe/ose
  - Trualli ku është bërë investimi.
- Në **rastndërtimi dhe/ose rikonstruksioni**, aplikanti dhe furnitori i punimeve/shërbimeve duhet të përgatisë dhe të mbajë të gjithë dokumentacionin teknik si projektet e ndërtimit/rikonstruksionit, duke përfshirë edhe dokumentet e tjera përkatëse siç i kërkon ligji shqiptar, dhe këto duhet të dorëzohen së bashku me kërkesën për pagesë siç përcaktohet në Udhëzuesin për Aplikantët.
- Për të qenë të pranueshme për mbështetje, projektet e investimit që propozohen duhet të jenë **ekonomikisht të qëndrueshme**. Qëndrueshmëria ekonomike tregohet përmes planit të biznesit. Për investimet/shpenzimet e pranueshme totale deri me 1,400,000 lekë, aplikanti duhet të përgatisë dhe të dorëzojë versionin e thjeshtuar të planit të biznesit dhënë në Shtojcën 2.1. Aplikanti me shpenzime të pranueshme totale mbi 1,400,000 Lek duhet të përgatisë dhe të dorëzojë një **plan biznesi** duke përdorur modelin e dhënë në Shtojcën 2.2, i cili duhet të tregojë qëndrueshmërinë ekonomike të pronave në fund të realizimit të projektit.
- Të gjitha pagesat në lidhje me investimet/blerjet duhet të bëhen me transferim bankar nga llogaria bankare e aplikantit në llogarinë bankare të furnitorit të shërbimeve ose mallrave në bazë të faturave sipas formatit zyrtar siç e kërkon ligji për ofruesit/furnitorët e regjistruar të shërbimeve.
- Kontratat me furnitorët e shërbimeve, makinerive, dhe të punimeve të ndërtimit së bashku me faturat origjinale duhet të dorëzohen bashkë me formularin përkatës të Kërkesës për Pagesë, dhe këto duhet të jenë firmosur pas firmosjes së kontratës midis aplikantit dhe nëpunësit autorizues të GIZ-it.
- Afatet e përcaktuara në Udhëzuesin për Aplikantët për finalizimin e investimeve në kontratën individuale për dorëzimin e Kërkesës për Pagesë duhet të respektohen. Shpenzimet dhe Kërkesa për Pagesë të paraqitura pas këtyre afateve do të konsiderohen të papranueshme.

## **18. Shtojcat:**

### **1. Formulari i Aplikimit**

### **2. Formularët e Planit të Biznesit**

2.1 Plan Biznesi për Investime deri në 1,400,000 Lek

2.2 Plan Biznesi për Investime mbi 1,400,000 Lek

2.2.1 Plan Biznesi për Investime mbi 1,400,000 Lek

2.2.2 Pjesa financiare e Planit të Biznesit për Investime mbi 1,400,000 Lek

2.3 Udhëzime për Aplikantët mbi mënyrën e plotësimit të Planit të Biznesit

### **3. Lista e Shpenzimeve të Pranueshme**

### **4. Lista e fshatrave të pranueshëm përkatësisht NjAQV**

### **5. Formulari i Kërkesës për Pagesë**